



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK BERAT
Komisioni i Arsimit, Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Barazisë Gjinore

RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: “Për miratimin e bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike për vitin arsimor 2025-2026”

Analiza ligjore: (bazueshmëria ligjore)

Propozimi mbështetet në ligjin nr. nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8, neni 9, neni 64, gërma “c”, **VKM nr.666, datë 10.10.2019** të ndryshuar **VKM nr.511, datë .27.7.2022** “.Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të vecanta në institucionet arsimore parauniversitare publike” **VKM nr.854, datë 24.12.2019**, “Për disa shtesa dhe ndryshime në **VKM nr.666, datë 10.10.2019** “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet e arsimore publike” të ndryshuar.

Situata aktuale e funksionit(përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

VKM Nr.666, datë 10.10.2019 të ndryshuar me **VKM Nr.511, datë .27.7.2022** “.Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të vecanta në institucionet arsimore parauniversitare publike”

VKM Nr.854, datë 24.12.2019, “Për disa shtesa dhe ndryshime në **VKM Nr.666, datë 10.10.2019** “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet e arsimore publike” të ndryshuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

a) në pikën 9 të të cilit shprehimisht citohet se : “Bursat e nxenesve për vitin e parë shqyrtohen dhe miratohen nga Këshilli Bashkiak sipas vendbanimit të përhershëm të prindit/nxënësit, përfitues të bursës/kuotës ushqimore “

b) Në pikën 4 të të cilit shprehimisht citohet se : “ Njesitë e vetëqeverisjes vendore , për uljen e nivelit të braktisjes shkollore për nxënësit që janë rregjistruar në arsimin bazë, por në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimimin, miratojnë bursa financiare me përfitues nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, pas konfirmimit nga mësuesi kujdestar dhe drejtori i shkollës për frekuentimin e procesit mësimor , si dhe nga Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar.

c) Në pikën 10.1. të të cilit shprehimisht citohet se:” Bursat e nxënësve për vitin e dytë e lart rishqyrtohen dhe miratohen çdo vit nga Këshilli Bashkiak, sipas vendodhjes territoriale e administrative të shkollave profesionale apo konvikteve ku janë vendosur nxënësit, përfitues të bursës/ kuotës ushqimore , sipas planit të bursave të miratuara në vitin paraardhës nga Këshilli Bashkiak i njesive të vetëqeverisjes vendore “

Shperndarja eshte si vijon:

1- 64 (gjashtëdhjet e kater) janë nxënës përfitues të bursës , aplikantët nga klasat e X (viti i pare) dhe aplikantët për herë të parë në klasat XI-XIII për MEKI dhe MASR nga këta:

a) 59 (pesëdhjet e nëntë) bursa të plota

b) 5 (pesë) bursa 50% (gjysëm burse)

1.1 26 (njëzet e gjashtë) janë nxënës përfitues, aplikantë për herë të parë në klasat XI-XIII të cilët i perkasin shkollave të mesme profesionale (MEKI) dhe (MASR) të mesme të përgjithshme nga këto:

1.1.1 17 (shtatëmbëdhjet) i perkasin (MEKI) shkollave te mesme profesionale

a) **13 (trembëdhjet) janë përfitues të bursës së plotë**

b) **4 (katër) janë përfitues me 50% (gjysëm bursë)**

1.1.2 9 (nëntë) janë përfitues të bursës së plotë të cilët i perkasin arsimit të mesëm të përgjithshëm (MASR)

1.2 38 (tridhjet e tetë) janë nxënës përfitues, aplikantë nga klasat e X (viti i pare) nga këta:

1.2.1 25 (njëzet e pesë) i perkasin shkollave të mesme profesionale (MEKI) nga të cilët

a) **24 (njëzet e katër) janë përfitues të bursës së plotë**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

- b) **1 (një)** është përfitues me 50% (gjysëm burse)
1.2.2 **13 (trembëdhjetë)** i përkasin shkollave të mesme të përgjithshme (MASR) janë përfitues të bursës së plotë.

2. 195 janë nxënës aplikante si ish përfitues nga vitet shkuara të cilëve nuk i kanë ndryshuar kriteret, nga këta :

- 2.1 **29 (njëzet e nëntë)** aplikantë nga shkollat e mesme të përgjithshme (MASR)
2.2 **166 (njëqind e gjashtëdhjet e gjashtë)** aplikantë nga shkollat e mesme profesionale (MEKI) nga të cilët **138 (njëqind e tridhjet e tetë)** përfitues të bursës së plotë dhe **28 (njëzet e tetë)** përfitues gjysëm burse.

3. 29 (njëzet e nëntë) janë nxënës përfitues të propozuar nga ZVA në shkresën me Nr.1504 prot, Date 17.12.2025 si nxënës, fëmijë të familjeve në nevojë, që janë regjistruar në arsimin bazë, por në pamundësi financiare, nuk e ndjekin arsimin bazë.

Drejtoria / Sektori përgjegjës

Drejtoria e Arsimit e Bashkisë Berat

Impakti social / grupet që preken:

Nxënësit e vitit të parë (Klasa e X) , me vendbanim në Berat, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar me kohë të plotë në institucionet arsimore publike sipas kriterëve të përcaktuara në VKM nr.666, datë 10.10.2019, pika.9 e këtij vendimi.

Nxënësit që ndjekin vitin e dytë e lart, aplikantë për herë të parë ose që kanë qënë përfitues të bursës/kuotës ushqimore , në vitin paraardhës (2024-2025) të cilëve nuk i kanë ndryshuar kriteret të përcaktuara në VKM nr.666, datë 10.10.2019 te ndryshuar VKM nr.854, datë 24.12.2019.

Nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, që janë regjistruar në arsimin bazë, por në pamundësi financiare, nuk e ndjekin arsimin bazë.

A është objekt i konsultimit publik:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ky material nuk është objekt i konsultimeve publike pasi është i përcaktuar në ligj.

Komisioni i Përhershëm për **i Arsimit, Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Barazisë Gjinore**, i mbledhur në datën 22/12/2025, shqyrtoi projekt vendimin “Mbi miratimin e bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike për vitin arsimor 2025-2026” relacionin e dokumentat shoqërues propozuar nga Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Arsimit

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash

VENDOSI

1. Miratimin e **255 (dyqind e pesëdhjet e pesë)** bursave te plota dhe **33 (tridhjet e tre)** bursa 50% (gjysëm burse), të shpërndara në **288 (dyqind e tetëdhjet e tetë)** nxënës përfitues, sipas listës bashkëlidhur.
- Për nxënësit e vitit të parë (Klasa e X) , me vendbanim në Berat, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar me kohë të plotë në institucionet arsimore publike sipas kriterëve të përcaktuara në VKM nr.666, datë 10.10.2019, pika.9 e këtij vendimi.
- Për nxënësit që ndjekin vitin e dytë e lart, aplikantë për herë të parë ose që kanë qënë përfitues të bursës/kuotës ushqimore , në vitin paraardhes (2024-2025) të cilëve nuk i kanë ndryshuar kriteret te përcaktuara në VKM nr.666, datë 10.10.2019 te ndryshuar VKM nr.854, datë 24.12.2019.
- Për nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, që janë regjistruar në arsimin bazë, por në pamundësi financiare, nuk e ndjekin arsimin bazë.

Komisioni i Arsimit, Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Barazisë Gjinore

Florenca Demollari- Kryetar i Komisionit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Donald Molishti-Anëtar

Kejsi Hoxha-Anëtar

Anduena Hazizolli-Anëtar

Barije Kanaci-Anëtar

Datë 22 /12/2025